



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 17, datë 10.06.2020

PËR

**“RISHIKIMIN E KUSHTEVE, SHTYRJEN E AFATIT DHE NDRYSHIMIN E
SUBJEKTIT ZHVILLUES, NË LEJEN EKZISTUESE TË RESORTIT TURISTIK
“GREEN COAST”, PALASË, BASHKIA HIMARË”**

Në mbështetje të Neneve 27, 28, 40 dhe 48, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Nenit 13, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Green Coast” sh.p.k. dhe Z. Aleksandër Frangaj, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Të miratojë rishikimin e kushteve dhe shtyrjen e afatit, në lejen ekzistuese të resortit turistik: “Green Coast”, Palasë, Bashkia Himarë”.
2. Të miratojë ndryshimin e subjektit zhvillues të “Resortit turistik “Green Coast”, Palasë, Bashkia Himarë”, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 8, datë 07.03.2014 “Për miratimin e Lejes Zhvillimore Komplekse për Resortin Turistik “Green Coast”, Palasë, Bashkia Himarë, për fazën / njësinë me numër 30, nga shoqëria “Green Coast” sh.p.k, në shoqërinë “Green Coast” sh.p.k. dhe Z. Aleksandër Frangaj.
3. Harta e Planvendosjes së Strukturave miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 13, datë 12.04.2017, “Për rishikimin e kushteve të lejes ekzistuese dhe shtesë në sipërfaqe, të resortit turistik “Green Coast”, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave, bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit sipas fazave/njësive të zbatimit, i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së diferencës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Bashkisë Himarë.

5. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

BLENDI KLOSI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

